

UDHËZIM
Nr. 3, datë 3.4.2019

PËR INFORMIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES NGA STRUKTURAT DHE SH.A.-të NË VARTËSI TË SAJ MBI ZHVILLIMIN E ANKANDEVE DHE LIDHJEN E KONTRATAVE NË ZBATIM TË PROCEDURAVE TË ANKANDEVE, PROKURIMEVE DHE MARRËVESHJEVE TË TJERA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ndryshuar, si dhe germës “P”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është informimi dhe monitorimi i aktivitetit të kryer nga strukturat dhe sh.a.-të në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes, në lidhje me aktivitetin e tyre ekonomik.
2. Informacioni në lidhje me aktivitetet e përmendura më sipër do të dërgohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Raportim periodik, në zbatim të këtij udhëzimi, do të jetë një përmbledhje e të gjitha aktiviteteve të zhvilluara nga strukturat dhe sh.a.-të, i cili do të paraqitet para Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes në intervale 3-mujore.
4. Udhëzimi do të zbatohet për procedurat e ankandeve, si dhe mbi procedurat e lidhjes së kontratave në zbatim të procedurave të ankandeve, prokurimeve dhe marrëveshjeve të tjera.
5. Udhëzimi do të zbatohet në mënyrë harmonike me detyrimet dhe procedurat e përcaktuara nga ligjet dhe aktet nënligjore të detyrueshme për organet dhe strukturat të cilat janë subjekt i këtij udhëzimi.

KREU II
INFORMACIONI PARAPRAK PËR SECILËN PROCEDURË

1. Përpara zhvillimit të ankandeve dhe lidhjes së kontratave, në zbatim të ankandeve, prokurimeve apo marrëveshjeve të tjera, strukturat e vartësisë dhe sh.a.-të, duhet të përgatisin një informacion të detajuar drejtuar sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Informacioni i përmendur në pikën 1 të këtij kreu, duhet të përmbajë:
 - a) llojin e procedurës që do të zhvillohet;
 - b) subjektin me të cilin do të lidhet kontrata;
 - c) ditën dhe mënyrën e zhvillimit të ankandit/prokurimit;
 - ç) mallrat dhe shërbimet që do të ofrohen nga secila palë.
3. Informacioni i mësipërm duhet të dërgohet minimalisht 3 ditë para zhvillimit të procedurës.

KREU III
RAPORTIMI PERIODIK

1. Strukturat dhe sh.a.-të në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes, në përfundim të çdo tremujori, duhet të përgatisin një raportim periodik për të gjithë procedurat e ankandeve, prokurimeve, si dhe kontratave të lidhura në zbatim të tyre dhe në zbatim të marrëveshjeve të tjera.
2. Ky raportim periodik i dërgohet sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, brenda datës 5 të muajit pasardhës të periudhës tremujore.
3. Raportimi periodik nënshkruhet nga titullari i strukturës ose sh.a.-së.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të gjithë strukturat dhe sh.a.-të në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Moszbatimi i detyrave, sipas këtij udhëzimi, përbën shkak për nisjen e procedurave disiplinore, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I MBROJTJES
Olta Xhaçka